



**REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr_____Prot

Vlorë, më____.____2026

PROCES VERBAL – Tipi i kontratës – e hapur e thjeshtuar , Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është pjesë e pandarë e publikimit bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti : Rehabilitim i Perroit ndermjet Rruges 4 Heronjte dhe Isa Boletini

Fondi Limit: 8.765.100 (Tetemilion e shtateqind e gjashtedhjetë e pesemije e njeqind) lekë pa TSVH

REF-00245-09-17-2026

Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtim

E Hapur e thjeshtuar ,Punë

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës ;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: "Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës .

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik": citojmë Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumenteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-së).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat 'a', 'b', 'd', 'dh', 'e', 'h', 'i', 'j' të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1

a. Punë të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarët i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të

plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Leje ndërtimi;
- Formular/Vërtetim-Vlerësimi nga Investitori.
- Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim: Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

1.1 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit te operatorëve ekonomik së bashku me ndarjen e punimeve mes operatorëve.

1.2 Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve".

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Licensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi” / EKVIVALENTE

Kategoria NP-4 Niveli A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”

Kategoria NP-7 Niveli A “ Ujesejelles kanalizime,vepra kullimi vaditje,Ndërtim konstruksioni ujesejellese,rrjete kanalaizimi te ujrave te bardha dhe te zeza, vepra hidraulike te ngjashme

Kategoria NP-12 Niveli A. Punime te Inxhinierise te mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit :

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve / EKVIVALENTE

NS-6 Niveli A Sinjalistike rrugore

Kategoria NS-12 Niveli A “Impiante teknologjik termik ./ EKVIVALENTE

Kategoria NS-18 Niveli A “ Punime Topogjeodezike.”

Kategoria NS 20 A Shpime gjeologo-inxhinierike,puse e shpime ne uje EKVIVALENTE

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

NP-1 A Punime gjurmimi në tokë

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure.

Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi dhe sistemimi të dherave. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit te dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Kategoria NP-4 Niveli A “Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale”

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure.

Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi dhe sistemimi të dherave. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit te dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Kategoria NP-7 Niveli A “ Ujesejelles kanalizime,vepra kullimi vaditje,Ndertim konstruksioni ujesjellese,rrjete kanalaizimi te ujrave te bardha dhe te zeza, vepra hidraulike te ngjashme

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure.

Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi dhe sistemimi të dherave. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit te dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Kategoria NP-12 Niveli A. Punime te Inxhinierise te mjedisit

A “ Ujesejelles kanalizime,vepra kullimi vaditje,Ndertim konstruksioni ujesjellese,rrjete kanalaizimi te ujrave te bardha dhe te zeza, vepra hidraulike te ngjashme

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjurmimi në tokë konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjurmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure.

Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjurmimi dhe sistemimi të dherave. Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjurmimit te dheut.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

N.S –1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar konsideron çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e rifiniturave te ndërteses me pajisje speciale ,prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure.

Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime prishje te suvatimit ekzistues ne mure,prishje mur tulle, cmontim dyer

dhe dritare ekzistuese, heqje shtrese me pllaka, prishje shtresa betoni, etj., Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

NS-6 Niveli A Sinjalistike rrugore

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi ë):

ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.

Objekti i parashikuar të ndertohet do të pajiset me sistem të plotë HVAC. Sistemi i propozuar në projektin HVAC është konceptuar posaçërisht për funksionin e objektit. Impianti i projektuar nëpërmjet këtij projekti është parashikuar - Impiant hidrik primar me prurje variabël dhe sekondar me prurje variable. Komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme në objektet e kësaj natyre. Në projektin mekanik HVAC, duke përfshirë zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike, si dhe pjesën përkatëse të preventivit dhe grafikut të punimeve për realizimin e secilit seksion të ndërtesës janë parashikuar të gjitha punimet për ndërtimin e rrjeteve, furnizimin dhe montimin e këtij sistemi. Për realizimin e këtyre punimeve në kriteret teknike është kërkuar që OE të zotërojë kapacitetet teknike profesionale për zbatimin e sistemit të plotë të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në përputhje me zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi. Vendosija e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive N.S - 12 B, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 12 B Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin ose Mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi ë):

ë) Mjediset e IAL-ve duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.

Objekti i parashikuar të ndertohet do të pajiset me sistem të plotë HVAC. Sistemi i propozuar në projektin HVAC është konceptuar posaçërisht për funksionin e objektit. Impianti i projektuar nëpërmjet këtij projekti është parashikuar - Impiant hidrik primar me prurje variabël dhe sekondar me prurje variable. Komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme në objektet e kësaj natyre. Në projektin mekanik HVAC, duke përfshirë zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike, si dhe pjesën përkatëse të preventivit dhe grafikut të punimeve për realizimin e secilit seksion të ndërtesës janë parashikuar të gjitha punimet për ndërtimin e rrjeteve, furnizimin dhe montimin e këtij sistemi. Për realizimin e këtyre punimeve në kriteret teknike është kërkuar që OE të zotërojë kapacitetet teknike profesionale për zbatimin e sistemit të plotë të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në përputhje me zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi. Vendosija e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive N.S - 12 B, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

NS-18 Niveli A “ Punime Topogjeodezike.”

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë,

Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, pika 1.5/a, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit.

Objekti i parashikuar të ndertohet ka një planimetri sheshi dhe një kufi prone me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe vështirësisë së të gjithë këtyre aspekteve u shtohet se godina është projektuar me një kat të “zhytur” 2.1m nën nivelin e tokës, për shkak të gjendjes së gjeologjisë së sheshit. Zbatimi jo i saktë i të projektit në të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni

N.S - 20A A Shpime gjeologo-inxhinerike,puse e shpime ne uje

Punime të tilla përfshijnë zbatimin e rëlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, Sikurse shtjellohet në specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, pika 1.5/a, mbështetur në dokumentacionin topografik të hartuar nga projektuesi dhe dokumentacionin e pronësisë së objektit, Kontraktori duhet të kryejë transferimin e pikave referenciale dhe gjurmës së objektit në terren, si dhe çdo shërbim tjetër topografik, të nevojshëm për zbatimin e saktë të projektit. Objekti i parashikuar të ndërtohet ka një planimetri sheshi dhe një kufi prone me formë të thyer, planimetritë e tij zhvillohen në disa nivele dhe disnivele, volumetria është komplekse dhe vështirësisë së të gjithë këtyre aspekteve u shtohet se godina është projektuar me një kat të “zhytur” 2.1m nën nivelin e tokës, për shkak të gjendjes së gjeologjisë së sheshit. Zbatimi jo i saktë i të gjitha nivelet mund të çojë në dëme kolosale dhe pamundësi teknike për realizimin e duhur të këtij konstruksioni.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me

a. **Licencë kategoria III.2.B** për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme”

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet te disponohen nga nga anetari qe do te kryejë shërbimet perkatese).

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt sipas Neni 8, Pika 2 te VKM -se Nr .448 date 31.07.2025** i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma.

Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai eshte i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë ofertuese, si më poshtë:

Inxhinier Ndertimi	2 (dy)
Inxhinier Elektrik	1(një)
Inxhinier Hidroteknik	1(një)
Inxhinier Gjeodet	1 (nje)
Inxhinier mekanik	1(nje)
Inxhinier mjedisi	1(nje)
Inxhinier Hidrogeolog	1(nje)

- Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për te paktën 3 muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Për inxhinierët duhet të paraqiten: Diploma, Kontratë individuale pune (e vlefshme), librezë pune, C.V.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat 'a', 'b', 'd', 'dh', 'e', 'h', 'i', 'j' të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Inxhinier Ndertimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zerrat e punimeve ndertimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit që prokurohet për secilin nga zerat e punimeve ndertimore, referuar punimeve te parashikuara ne preventiv dhe kategorisë se kërkuar në licencën profesionale te shoqërisë.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zerat e punimeve hidroteknike, referuar punimeve të parashikuara ne preventiv dhe kategorisë se kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Mjedisit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit që prokurohet për secilin nga zerat e punimeve ndertimore, referuar punimeve te parashikuara ne preventiv dhe kategorisë se kërkuar në licencën profesionale te shoqërisë.

Inxhinieri Mekanik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike te objektit që prokurohet për secilin nga zerat e punimeve te instalimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara ne preventiv dhe kategorisë se kërkuar në licencën profesionale te shoqërisë.

Inxhinieri Elektrik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit qe prokurohet per secilin nga zerat e punimeve Elektrik, referuar punimeve te parashikuara ne preventiv dhe kategorisë se kërkuar në licencën profesionale te shoqërisë.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e këtyre punimeve. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, datë 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar parashikohet se: "Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari te caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve te zbatimit duke u mbështetur në: profilin e diplomës universitare te individëve qe punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë."

Sa më sipër, duke marrë parasysh natyrën e punëve te objektit te prokurimit, ka përzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, te cilët janë te nevojshëm per realizimin e punimeve duke u bazuar ne natyrën e kësaj pune.

